



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# ÇKA ËSHTË MBITËRHEQJA (OVERDRAFTI)?



# ÇKA ËSHTË MBITËRHEQJA (OVERDRAFTI)?

Mbitërheqja (overdrafti) është një formë e kredisë afatshkurtër (zakonisht lidhet me pagën e individit) e cila lejon që llogaria bankare të mbahet nën zero, duke e lejuar mbajtësin e llogarisë të tërheqë më shumë para sesa realisht ka në llogari.

**P.sh. Nëse një person ka në llogari bankare një shumë prej 500 eurosh dhe dëshiron të tërheqë 600 euro. Në këtë rast mbitërheqja do të aktivizohet dhe personi do të ketë në dispozicion 100 euro më shumë sesa që ka realisht në llogari. Kjo shumë konsiderohet si borxh dhe është e dobishme për situata emergjente ose nevoja të tjera të pashmangshme.**

# DIËA KËSHILLA SE SI TA PËRDORNI KËTË SHËRBIM ME KUJDES DHE TË MOS RREZIKONI TË HYNI NË BORXH TË TEPËRT:

1. Mbitërheqja funksionon si një formë e kredisë afatshkurtër, por në vend të tërheqjes së një shume të caktuar në një kohë të caktuar, ajo lejon tërheqje të vazhdueshme derisa të arrihet limiti i mbitërheqjes. Në këtë mënyrë, mbitërheqja mund të jetë e dobishme për situata emergjente, por duhet përdorur me kujdes për shkak të kostos së saj të lartë.



2.Pyetni bankën a aplikon tarifa dhe interes për këtë lloj kredie dhe sa janë ato.

Tarifat mund të jenë fikse ose të ndryshueshme. Në disa raste, interesi mund të jetë më i lartë se sa interesi për kredi të tjera bankare.

Pagesa e overdraftit bëhet automatikisht, në momentin që kreditohet llogaria (në momentin që ju del paga në llogari).



**3. Përdorni mbitërheqjen vetëm për emergjenca. Mbitërheqja është një opsion i mirë në raste emergjente, siç janë shpenzimet e papritura mjekësore, pagesat e papritura ose për të marrë përfitime nga një ofertë e kufizuar. Nëse mbitërheqja përdoret për shkak të shpenzimeve të rregullta, mund të jetë shenjë e një problemi më të thellë financiar.**



CONTRACT

**4. Sigurohuni që keni lexuar dhe kuptuar të gjitha rregullat dhe tarifat e mbitërheqjes para se të vazhdoni.**

An illustration of a man with blonde hair and glasses, wearing a yellow polo shirt, dark blue suspenders, and dark blue trousers. He is holding a large, light blue pencil with a yellow eraser and a black tip. He is standing next to a large, light blue document that looks like a contract. The document has the word "CONTRACT" at the top, followed by several horizontal lines representing text. Below the text, there is a signature in black ink. The background is a solid blue color.

*[Signature]*

## 5. Monitoroni llogarinë tuaj.

Nëse merrni një mbitërheqje, kontrolloni rregullisht llogarinë tuaj për t'u siguruar që nuk po e rritni shumën e borxhit. Përpiquni ta ktheni llogarinë në zero sa më shpejt që të jetë e mundur.



## **Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

Adresa: Rr. Garibaldi nr. 33,

Prishtinë, Kosovë

[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

E-mail: [info@bqk-kos.org](mailto:info@bqk-kos.org)

Telefon: +383 38 222 055

Fax: +383 38 243 763